



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

02-10-2023

Planor - Projekta e Komuna	
Nr. i organit	
Org broj	

01-110/05-1194



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 12, shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2023, neni 9, te ndarja dhe rindarja e fondeve të bartura si dhe obligimet e pakryera financiare nga viti paraprak, pika 1,2, bilancet e pashpenzuara të të hyarve vetanake të komunave, neni 36, paragrafi 36.2, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më datën 27.09.2023 merr këtë:

V E N D I M

për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit me Nr.01-110/05-756, të datës 31.05.2023 për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2022 në vitin 2023

Neni 1

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për ndryshimin - plotësimin e vendimit me nr. 01-110/05-756 të datës 31.05.2023 për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2022 në vitin 2023

Neni 2

Konform nenit 1 të këtij vendimi, vendimit me nr. 01-110/05-756 të datës 31.05.2023 për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2022 në vitin 2023, duhet të plotësohet - ndryshohet ku neni 2 i vendimit baze ku thuhet; Rregullimi i fushave sportive, kod (44152), shuma prej 69,157.61 €. Ndryshohet - plotësohet dhe duhet të jete: Rregullimi i fushave sportive në fshatin Drobesh, Goshicë e Beguncë – projekt i ri shuma prej 69,157.61 €.

Neni 3

Të gjitha pjesët tjera të Vendimit Nr. 01-110/05-756 të datës 31.05.2023 për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2022 në vitin 2023 mbeten në fuqi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryetari dhe Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim e Komunës së Vitisë.

Neni 5

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 8 lidhur me nenin 9 të Rregullores Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi ju dorëzohet:

1. Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim;
2. Zyrës së Kryetarit;
3. Shërbimit të Kuvendit; dhe
4. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË

K R Y E S U E S I

Bekim Azizi

